VENDIM
Nr. 164, datë 19.2.2020

PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS, DHE CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE

(Ndryshuar me VKM nr. 482, datë 30.7.2021)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve "iii" e "iv", të shkronjës "b", të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, zonë e re për zhvillim.

2. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për këtë zonë, për ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

(Zëvendësuar harta dhe koordinatat me VKM nr. 482, datë 30.7.2021)



Koordinatat e Zonës së Re për Zhvillim;

Pika	X_Koord	Y_Koord
1	371536.4	4577235
2	370976.3	4578298
3	372345.7	4579022
4	372449.4	4579020
5	372980.9	4578007
6	371536.4	4577235
7	369750.2	4577742
8	370461.5	4576662